



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Department za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

Ministria e Zhvillimit Ekonomik shpallë **KONKURS PËR AVANCIM** të nëpunësve civil për këtë vend të punës:

Departamenti i Integrimit Evropian, Koordinimit të Politikave dhe Zhvillimit Ekonomik

Numri i konkursit: APF0002669

Vendi i punës: Drejtor i Departamentit për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave - IE/010 / JP00031397

Koeficienti : 10,00

Kohëzgjatja e Emërimit: Pa afat të caktuar

Mbikëqyrësi: Sekretari i Përgjithshëm

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron mbështetje në bashkërendimin e aktiviteteve për procesin e Integrimit Evropian;
- Monitoron dhe raporton për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian;
- Ofron mbështetje në harmonizimin e legjislacionit të ministrisë me Acquis Communautaire;
- Koordinon aktivitetet e Ministrisë për mbështetjen financiare nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA) dhe fondet tjera të Bashkimit Evropian;
- Kontribuon në shkëmbimin e informatave në funksion të procesit të integrimit evropian për fushë-veprimtarinë e ministrisë;
- Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/ strategjive të zhvillimit ekonomik;

- Ofron mbështetje për institucionet tjera përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve të politikave/ strategjive sektoriale nga fusha e zhvillimit ekonomik;
- Propozon, harton dhe siguron zbatimin e udhëzimeve për formën dhe përmbajtjen e strategjive sektoriale dhe nder-sektoriale për zhvillimin ekonomik dhe për monitorimin e tyre;
- Ofron mbështetje në përgatitjen e strategjive të zhvillimit të sektorit energjetik, mineral, postar, të komunikimeve elektronike dhe të shoqërisë së informacionit, si dhe programet e zbatimit të tyre;
- Përgatit dhe përditëson, në koordinim me institucionet përkatëse, bazën e të dhënave për zhvillimin ekonomik kombëtar;
- Përgatit periodikisht dhe publikon, në koordinim me institucionet përkatëse, analiza të treguesve ekonomik për zhvillim ekonomik kombëtar dhe sektorial;
- Harton raporte të rregullta periodike mbi zbatimin e dokumenteve politikave/strategjike të zhvillimit ekonomik;
- Bashkëpunon me Ministrinë e Financave për përcaktimin e treguesve kryesor të buxhetit të shtetit dhe përparimit të investimeve publike;
- Organizon konferenca dhe debate publike me tema të lidhura drejtpërdrejtë me zhvillimin ekonomik në Republikën e Kosovës;

Kualifikimi i nevojshëm :

- Diplomë universitare në lëmin e integritimeve Evropiane, juridike, ekonomike (Diplomë master në lëmin e integritimeve Evropiane, juridike, ekonomike është përparësi)
- Të këtë 7 vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku 4 vite në pozitë drejtuese/menaxheriale
- Njohja e mirë e politikave dhe legjislacionit të komunitetit evropian, marrëveshjeve multilaterale dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
- Shkathtësi të lartë në menaxhim, organizim, caktim të objektivave dhe planifikim;
- Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit;
- Shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocimit;
- Qasje fleksibile ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve Microsoft Office;
- Njohja e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera të huaja është përparësi;
- Trajnimet në fushën e ekonomisë, juridike dhe integritimit Evropian janë përparësi

**INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT
PER AVANCIM**

Procedura e konkurrimit është e hapur për nëpunës civil ekzistues në MZHE, te cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim. MZHE ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MZHE-së. Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net>

Së bashku me formularin zyrtar të punësimit duhet të dorëzohet dëshmia për kualifikim shkollor, kurset e ndjekura, dëshmitë për përvojën e punës, dy vlerësimet e fundit të punës si dhe dy referenca. Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

Afati i konkurrimit është prej datës 27 /10/ 2017 deri me date 03 /11/ 2017, deri në orën 16:00.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524